

tia

# MOOJI

PYETJE DHE  
PERGJIGJE

## TI JE AJO

Cfarë ti je përpara se ti u bëre

Përktheu **Ledion Azemaj**



Ky botim elektronik u publikua në Shqip në vitin 2023 nga Ionweb  
Përktheu **Ledion Azemaj**

**ionweb**

## **RRETH AUTORIT**

**Mooji** (Anthony Paul Moo-Young) është një dishepull i mjeshtrit madhështor Advaita, Sri H.W.L. Poonja ose ndryshe Papaji, siç ai njihet me dashuri nga studentët. Mooji lindi më 29 janar 1954 në Port Antonio, Xhamajka.

Ai më vonë u transferua në Brixton, Londër ku jetoi për më shumë se 40 vjet. Këtu, Hiri e bashkoi në një takim me një mistik të krishterë që bëri që Mooji të "largohej nga jeta e tij" - një shprehje që ai e përdor për të përcjellë thellësinë e atij takimi.

Atje nuk kishte më një ndjenjë autonomie personale. Me fjalët e tij ai thotë: "Ndjeva se isha ulur në prehrin e Zotit. Një paqe e thellë dhe një besim te Supremi lindi në zemrën time dhe është këtu edhe sot."

I intriguar nga ky ndryshim madhështor në perceptim dhe duke dashur të shkrihej plotësisht në të Vërtetën, Mooji zbuloi mësimet e shenjtorit të madh Indian, Sri Ramakrishna, thëniet e të cilit e kënaqën thellësisht zemrën e tij.

Kjo lidhje e shtyu Moojin të udhëtonte për në Indi, ku, në dukje rastësisht, do të takonte Mjeshttrin e tij të gjallë, Papajin. Atje, në këmbët e Papajit, gjithçka që kishte mbetur nga një ego funksionale u shkëlqoi përfundimisht.

Duke njohur shkëlqimin e Moojit, njerëz nga pjesë të ndryshme të botës filluan t'i afroreshin atij në kërkim të përvojës së drejtpërdrejtë të së Vërtetës. Aftësia për t'i udhëhequr ata lindi në mënyrë spontane tek ai.

Megjithëse prania e Moojit mbart një aromë përkushtimi, fjalët që burojnë nga qenia e tij janë të natyrës së jo-dualitetit.

Udhëheqja e tij ngjall dashurinë dhe njohjen e drejtpërdrejtë të Vetes së përjetshme që ne jemi. Tregimet e pakursyera të Moojit drejt së Vërtetës, përmes metodës së vetë-hetimit, formon themelin e këtyre pikave.

Mooji ia kushton jetën pa zgjedhje thirrjes së Zembrës. Është kjo ajo që ka krijuar Monte Sahajën, një qëndër ashrami që u ndërtua në jug të Portugalisë. Siç vetë Mooji shpjegon; "Isha i detyruar të vija këtu, i udhëhequr nga një prani e padukshme, në mënyrë që kërkuesit të mund të takojnë Zotin e vërtetë të tokës brënda zembrës së tyre."

# PYETJE DHE PERGJIGJE

-DAMIEN:

**Cila është mënyra më e mirë për të shkuar përpara për njerëzimin?**

**MOOJI:** Më kujtohet dicka që mjeshtri im tha kur ai u pyet se “Cfarë duhet që njeriu të bëjë në mënyrë që të transformojë një jetë nga ajo e një krize tek ajo e harmonishme?”. Papaji u pergjigj duke thënë se “*Mankind duhet të bëhet kind man.*”

(man- njeri, kind- i sjellshëm)

Mirësia për të cilën mjeshtri im flet, është ajo për të cilën ne duhet të rimbulojmë sërish. Njeriu duhet të bëhet i thjeshtë dhe i hapur përsëri. Ai duhet të mësojë nga gabimet e tij dhe gjithashtu të besojë dhe të bashkëpunojë me fuqinë më të lartë. Njeriu nuk duhet të bëhet viktimë e projeksioneve të tij të kota. Ai duhet të bëhet i mënçur nëpërmjet njohurive dhe të kuptuarit të përsosur. Ai duhet të mësojë nga qëniet e mënçura në Tokë. Ajo që duhet të ndodhë është një ndryshim i fuqisë, nga manual në automatik.

Me këtë unë nënkuptoj një riorientim nga një mënyrë personale e vetëdijes - ku "unë" funksionon si ego, në një mënyrë jopersonale të vetëdijes, e cila përjetohet si "Unë" - prania e papërzier. Por kjo ndodh vetëm kur vetëdija jonë thellohet deri në atë masë ku ajo pushon së funksionuari si thjesht një entitet psikologjik ose ego-mëndje dhe funksionon nga këndvështrimi i qënies së pashoqëruar, kuptimi natyror "Unë Jam".

Pra, mëndja e përqëndruar në ego nuk mund të rregullojë vërtet lirinë e saj. Mirësia luan një rol të rëndësishëm në zgjimin nga ëndrra e një vetëdije personale. Mirësia na detyron ne të ndalojmë së shikuari projeksionet e mëndjes dhe na prezanton të shqyrtojmë me të vërtetë vetveten thellë me një vetëdije të pastër dhe një gatishmëri për të ndryshuar atë që nuk është në harmoni me dritën dhe mënçurinë e zemrës sonë.

**-DAMIEN:**

**Shënjat shkencore tregojnë se universi do të ketë një fund të pashmangshëm;  
Cfarë mendon për këtë?**

**MOOJI:** Shkenca është një shprehje e madhe e vetëdijes e cila ka kontribuar në përvojën njerëzore. Megjithatë, parashikimet shkencore janë vërtetuar të gabuara në shumë raste dhe shumë parashikime të katastrofave të caktuara nuk kanë ndodhur. Pse?

Sepse në përgjithësi, jeta nuk është aq e parashikueshme sa mendja jonë shpesh e imagjiron atë. Jeta në esencë funksionon në harmoni, ajo nuk po përpiket të shkatërrojë vetveten; në fakt, përkundrazi, jeta kujdeset për jetën. Njeriu nuk është menaxher i ekzistencës. Mendja e njeriut është një fuqi shumë më e vogël sesa mendja kozmike. Megjithëse vetëdija në shprehjen e saj si qenie njerëzore manifeston një diversitet të jashtëzakonshëm; një fuqi më e lartë, shumë përtej aftësisë së njeriut për të kuptuar, mbizotëron si nënshtresa e gjithë ekzistencës.

Sikur ta kuptonim këtë, ne do të kishim më shumë besim në mendjen kozmike, në dashamirësinë dhe inteligjencën e saj dhe kështu të jetonim një ekzistencë më harmonike me natyrën. Ti mund të pyesësh se nëse është hiri ajo që na shpëton nga fenomene të tilla. Po, hiri luan një rol të madh në këtë. Por unë dua ta përdor hirin në një mënyrë të hapur, jo në një mënyrë që njerëzit të mendojnë se ata nuk kanë asnjë rol për të luajtur dhe të mbyllin mendjen ndaj veprimeve spontane dhe të mënçura që rrjedhin nga zemrat e tyre.

**-DAMIEN:**

**A ekziston mundësia e një pike kthese të bashkuar shpirtërore, ose një prag kritik në të cilën natyra jonë shpirtërore mund të shndërroj ose ndryshojë rrjedhën e së ardhmes sonë?**

**MOOJI:** Njeriu nuk mund ta dijë të ardhmen; ai vetëm mund të spekulojë për të. Atje ekziston gjithmonë mundësia që jeta, natyra, Zoti – sido që të zgjedhim ta quajmë atë – mund të sjellë një fatkeqësi, por ne nuk do të ishim në gjëndje të parashikonim kohën e ndodhjes dhe madhësisë së saktë të saj. Vlerësimi ynë për fenomene të tilla do të ndryshojë nga personi në person,

nga kombi në komb. Çdo ngjarje e madhe ka rezultate të panumërta në varësi të pjekurisë së perceptimit. Një "fatkeqësi" mund të sjellë ndryshime të ndricuara në kulturën njerëzore dhe të riformësojë këndvështrimin tonë duk ngritur nivelin e vetëdijes.

Të gjitha vlerësimet janë vlerësime subjektive, asnjëherë objektive, dhe ne shpresojmë se ato çojnë në pranime përlulëse se ne nuk jemi vërtet sundues të fatit. Pra, kjo pikë kthese shpirtërore nuk është diçka që njerëzimi mund ta krijojë. Edhe nëse njerëzimi ka aspiratën për të, ne nuk kemi treguar fuqinë për të gjeneruar ndonjë forcë reale për ndryshim. Edhe në mesin e njerëzve që bashkohen për një të mirë të përbashkët, ka aq shumë perspektiva të fragmentuara, aq shumë dallime mendimesh, sa që ato shpesh e mposhtin qëllimin e tyre origjinal.

Ti mund të pyesësh: "Po ato qenie që kanë arritur kulmin e potencialit shpirtëror njerëzor, që do të thotë - ata që kanë realizuar unitetin e tyre të qënësishëm me burimin e jetës dhe janë mishërimi i gjallë i kësaj - a nuk kanë ata fuqinë të na drejtojnë një rrugë të re?". Jo, nuk funksionon kështu. Ne nuk mund të mbështetemi në qenie të tilla të ngritura shpirtërisht për të ndërhyrë në emër të njerëzimit nëse shkakut i dëshiruar për të cilin ndihma e tyre kërkohet është thjesht për t'iu përshtatur dëshirave, projeksioneve dhe fantazive egoiste. Ata nuk do - dhe nuk mund - të veprojnë kundër vullnetit të Supremit. Duke qënë të paanshëm në perceptimin e tyre, ata nuk gjejnë asnjë faj, si të tillë, në lojën jashtë emrave dhe formave.

**-DAMIEN:**

**Pra, duhet ti lejojmë që gjërat të jenë kështu sic ato janë?**

**MOOJI:** Epo, ne nuk e dimë se si gjërat janë. Ne kemi një ide në mendjen tonë se si ato janë. Si fillim, njeriu ka një keqkuptim madhështor të natyrës së tij reale. Ai e koncepton veten si një qenie psikologjike dhe projektton neurozën e tij mbi botën. Rrjedhimisht, ai nuk mund të mos përpiqet të "rregullojë" botën që ai beson se lyp për mesianitetin e tij, një kompleks të thellë që ai e çmon brënda vetes. Kështu, ai banon në një mbretëri të fantazisë së vetë-fryrë të zotërimit të fuqisë autonome për të transformuar një botë që ai e ka krijuar nga mendja e tij e mashtruar. Ai imagjimon se ka

nevojë të "shpëtojë" diçka ose dikë, por ai ka harruar të përfshijë veten në misionin e tij.

**-DAMIEN:**

**Mendon se edhe njerëzit që mblidhen me qëllimin për të bërë ndryshime "pozitive" - për të punuar kundër asaj që kërcënon ekzistencën e njeriut në këtë planet - që gjithë kjo energji është e humbur?**

**MOOJI:** Mos u dëshpëro. Ka diçka në brëndësi të njeriut që është e përsosur, e përgjithshme, e plotë – qenia dhe natyra e tij origjinale. Ai duhet të kërkojë dhe zbulojë Vetëveten e tij të vërtetë. Por ai vuan shumë nga shpërqëndrimi, për shkak të kushtëzimit intensiv psikologjik dhe identitetit të rremë. Ai shikon atë që identiteti i tij deceptiv imagjinon, në vënd që të kërkojë vetë atë identitet deceptiv.

Transcendenca e çdo besimi rreth vetes si një person në njohjen e qënies së tij si prani e vetëdijshme është sfida e tij më e lartë dhe më e thellë. Besnikëria e tij ndaj kushtëzimit të tij të kësaj bote errëson njohjen e tij intuitive të qënies së tij të përjetshme, dhe kështu ai fle. I paaftë për të njohur dhe pranuar iluzionin e tij, ai mbetet i pavëmëndshëm ndaj vet-Vetes së tij të përsosur. Në mënyrë të pabesueshme, kur ai të fillojë të hetojë veten, ai do të arrijë të njohë identitetin e tij të kushtëzuar si veçse një konstrukt të thjeshtë të një mendimi psikologjik.

Në momentin e një depërtimi kaq të thellë, ai spontanisht do të njohë qënien e tij të vërtetë si vetëdije në dritën e së cilës nocioni joreal i vetvetes shihet. Bota që ai imagjinonte se banonte ishte një pasqyrim i projeksioneve të tij psikike. Nëse njeriu vjen në një zbulesë të tillë, ai ka arritur potencialin e tij më të lartë. I gjithë falsiteti fillon të ndizet në flakë dhe ai ngrihet si feniks nga hiri i iluzioneve të tij dhe lirohet nga burgu i ëndrrës së tij. Jam i lumtur që kam mundësinë të flas kaq troç për këtë. Jam i vetëdijshëm se kjo nuk do të jetë aq e këndshme për mëndjen e kushtëzuar, por është jetike dhe një lëvizje e shpejtë drejt lirisë - nëse liria është ajo që ne po kërkojmë me të vërtetë.



**-DAMIEN:**

**Në librin e tij "UNË JAM AJO", Nisargadatta Maharaj tha se - "në botën time, asgjë nuk shkon keq". A është kjo se si të gjithë ne duhet ta shohim në esencë jetën tonë, nga një këndvështrim më të lartë?**

**MOOJI:** Jo, ti nuk mund ta bësh këtë. Ti mund të përpiqesh ta bësh këtë, por pa përvojë të drejtpërdrejtë të kësaj hapësire nga ku dhe siç Sri Nisargadatta Maharaj po flet, ajo do të jetë vetëm një gjëndje mendore e sajuar - një pretendim që nuk do të zgjasë. Kur Sri Maharaj thotë, "Në botën time", ai nuk do po thotë, "Në botën time personale si "unë", personi, Sri Nisargadatta Maharaj".

Ai po thotë se në botë, siç shihet përmes syve të vetëdijes jopersonale, asgjë nuk shkon keq. Në nivelin sipërfaqësor, mund të duket se diçka po shkon keq, por nga hapësira e vetëdijes së pastër, njeriu sheh se gjithçka ka një rol për të luajtur dhe ka pamjen e vet të caktuar në kohë. I urti e di këtë dhe është një me shpalosjen dinamike dhe spontane. Jeta nuk është asnjëherë ajo që ti mendon se ajo është. Jeta bëhet pikërisht ajo që ti e imagjinon të bazohet në perceptimin njerëzor kur ajo formësohet nga kushtëzimi, dëshira dhe besimi personal. Këto ngjyrosin atë se "*Çfarë është*" dhe e bëjnë atë të duket ndryshe nga ajo që ajo është.

I zgjuari ka tejkalar identitetin egoik dhe nuk është më një person. Ai është i lirë nga dëshirat dhe motivet personale dhe qenia e tij është një me vetëdijen universale. Është një përafrim i lehtë me gjithçka që ekziston. Prandaj, ai është natyrshëm i lumtur. Kjo gjithmonë do të turbullojë egon, e cila punon pa u lodhur në jetë me përpjekje dhe tendosje. Asaj i mungon thjeshtësia e qënies. Jeta e të urtit tregon se Vetja më e lartë e njeriut është në unitet pa mundim me kozmosin.

**-DAMIEN:**

**A mund ta mbajmë këtë gjëndje të "asgjë nuk shkon keq" të vazhdueshme kur ne vetë arrijmë vetëdijen e pastër?**

**MOOJI:** Kjo, në rastin më të mirë, do të ishte vetëm një besim. Kjo gjëndje e "asgjë nuk shkon keq" është një zbulim, jo rezultat i disa përpjekjeve. Nuk ka asnjë mbajtës të kësaj gjëndje dhe as nuk ka njeri që

mund ta arrijë atë. Nëse do të kishte një person që duhej ta arrinte dhe më pas ta mbante atë gjëndje të vetëdijes, ai nuk do të mund ta bënte këtë, sepse personi, në fakt, nuk ekziston në realitet. Si mund të mbajë një person ndonjë gjëndje kur ai vetë është vetëm një imazh në vetëdije?

Sri Nisargadatta Maharaj po flet nga dhe si Vetëdije e Palindur, e cila e vetme është konstante dhe reale. Nga e Palindura, kjo gjëndje e vetëdijes "Unë Jam" vërehet vetë. Pra, edhe "Unë Jam", kjo gjëndje e pranisë, sado madhështore që ajo është, nuk është realiteti përfundimtar. Përtej gjëndjes "Unë Jam", asnjë përpjekje nuk mund të bëhet, sepse çfarë fshihet përtej është Vetëdija e Palindur. Asgjë e observueshme apo e ditur nuk mund të arrijë atje. Kjo Vetëdije e Palindur duhet të kapet në mënyrë intuitive dhe të konfirmohet energjikisht si realiteti përfundimtar i yti.

**-DAMIEN:**

**Shumica e mësuesëve flasin për njëshmërinë, se si ne të gjithë jemi në esencë një vetëdije. Megjithëse shumë kërkues mund ta kuptojnë intelektualisht këtë concept, kaq pak duket se e përjetojnë plotësisht atë. Si mundet që ne vërtetë ta përjetojmë atë gjëndje përfundimtare të njëshmërisë? Si ta sjellim këtë në jetën tonë të përditshme?**

**MOOJI:** Si mund ta përjetojmë vërtet këtë gjëndje përfundimtare të njëshmërisë? Njëshmëria nuk është një përvojë që ti mund ta kesh dhe pastaj të largohesh. Gjëndja e njëshmërisë nuk është për dikë, ajo është vetëm për askënd. Vetëm z. apo znj. Askush e njeh këtë gjëndje uniteti. Z. ose znj. Dikush nuk mund ta njohë këtë. Qëllimi kryesor i spiritualitetit, nëse dëshiron të jesh i drejtpërdrejtë, nuk është të përpiqesh të jesh një me gjithçka.

Qëllimi i vetëm dhe suprem është të zbulosh dhe të jesh ai që ti je. Nëse zbulon se kush ti je, automatikisht do ta kuptosh dhe do të jesh ai unitet në një nivel të gjallë. Njëshmëria nuk do të thotë që unë duhet të dukem si ty. Njëshmëria nuk do të thotë as që unë duhet të të pëlqej ty. Nuk është se ne po bëhemi të gjithë "një", si një lloj mënyre e një uniteti fetar, projeksioni apo vizioni.

Njëshmëria do të thotë se ajo që është zbuluar këtu në këtë trup si terren i pandryshueshëm i qënies, funksionon si i njëjti realitet në brëndësi të çdo trupi. Ajo është burimi i përbashkët i të gjitha manifestimeve. Pasi ta kesh

kuptuar në mënyrë të palëkundur Vetveten – se ti je Ajo – atëherë nuk mund të mos e shohësh se ajo është e njëjta Vete që shfaqet në të gjithë trupat. Kjo është çfarë njëshmëria do të thotë dhe është. Duke e ditur këtë, njeriu nuk mund të ketë synimin për të dëmtuar me të vërtetë "tjetrin", pasi atje është vetëm një Vete që shfaqet si shumë. Kjo Vete shpreh dashurinë dhe dhëmbshurinë për të gjitha qëniet si forma të Vetes së saj.

**-DAMIEN:**

### **Si mundet ta sjellim këtë në jetën tonë të përditshme?**

**MOOJI:** Përsëri, kjo është një pyetje e ndërnuar plotësisht mbi nocione të rreme. Nuk ka asnjë "ne" që mund ta sjellë këtë në jetën tonë. Ne jemi tashmë – dhe gjithmonë - e vetmja Vete e përsosur, thjesht nuk jemi të vetëdijshëm për këtë të vërtetë për shkak të faktit se ne besojmë se jemi kushtëzimi trupmëndje. Të gjitha idetë e bazuara në përpjekjet njerëzore për të arritur gjëndjen përfundimtare prodhojnë vetëm një simulim të çlirimit. Mëndja përpiket të imitojë cilësinë dhe aromën e Vetes së pastër përmes imagjinatës.

Dhe nëse shkojmë me mëndjen, ne mund të mendojmë se po bëjmë hapa madhështor drejt realizimit të Vetes sonë të pakufishme, por gjithçka që ne realisht po bëjmë është se po shkëmbejmë kushtëzimin e kësaj bote me kushtëzimin shpirtëror, kjo është e gjitha. Mos u dëshpëro. Nëse dëshira dhe qëllimi yt është të zbulosh të vërtetën përfundimtare, të pandryshueshme dhe përfundimtare, vetëm praktika nuk do ta zbulojë atë, dhe kjo është një gjë e mirë. Pse? Sepse do të thotë se zbulimi i vetvetes nuk kërkon aftësi në të cilën ti mund të dështosh. Ajo që praktika mund të bëjë është të ekspozojë gënjeshtren ose të të bëjë ty të shohësh gënjeshtren. Kjo tashmë është diçka e fuqishme. Megjithatë, njohja e plotë e së vërtetës kërkon gjithashtu mirësi.

Mirësia është gjithmonë e pranishme dhe mirësia e një mësuesi - ai që tashmë ka tejkaluar ndikimin e mëndjes egoike dhe që zotëron autoritetin dhe fuqinë për të udhëhequr kërkuesit përtej sferës komplekse të fenomenalitetit - fshin identitetin e egos. Ky nuk është një proces krijues. Është një zbulim i së vërtetës që ka qënë gjithmonë prezente, por që dukej e eklipsuar nga besimi se ne jemi personalitetet tona.

**-DAMIEN:**

**Pra, cila është pyetja më e mire për t'lbërë një mjeshtritë gjallë?**

**MOOJI:** A mundem unë të gjej dhe të bëhem ajo që Buda, Krishti ose një nga mjeshtrat e mëdhenj shpirtërorë zbuloi tani, sot, dhe nëse jo, çfarë po më ndalon? Është e gjitha çështje fati apo mundem të bëj diçka për të? A duhet ta lë rolin tim aktual në jetë, familjen time, karrierën time, në mënyrë që të zbuloj se çfarë është e vërtetë? Pyetje të tilla do të ishin më të mirat për t'ia bërë një mjeshtri të gjallë, nëse ke rastin të takosh një të tillë.

**-DAMIEN:**

**Bota rreth nesh duket plotësisht reale sipas edukimit tonë. Nga vjen dëshira për të ngritur pyetje të tilla, për të sfiduar kushtëzimin tonë?**

**MOOJI:** Ne kemi qënë shumë të kushtëzuar në një mënyrë cerebrale. Koncepti i një realiteti objektiv është bërë mbështetja jonë rrënjësore. Ne besojmë fuqishëm në dëshminë e shqisave dhe mendjes në aspektin e tyre si funksionime të mirëfillta, racionale dhe logjike. Këto janë aspekte dhe aftësi në brëndësi të qënies sonë, por kapaciteti ynë si vetëdije është shumë më i gjerë se këto.

Dhe kështu, nuk është e paimagjinueshme që nga diku në brëndësi të kësaj vetëdijeje madhështore, dëshira për t'u zgjuar nga ky gjumë injorance mund të lindë spontanisht pa agjensinë njerëzore. Një ngjarje e jashtme, si psh; një aksident, mund të jetë një shkaktar. Por për disa qenie të rralla, kur ata dëgjojnë vetëm një fjalë të vetme të së vërtetës që atyre u thuhet, apo edhe takimin e thjeshtë me praninë e heshtur të një qenieje të zgjuar, ata gjejnë se zemrat e tyre hapen me një kënaqësi të madhe ndaj kësaj.

Ndërsa ne fillojmë të pyesim mendjen tonë, gjithçka që është e pavërtetë – besimi ynë në koncepte të caktuara, kushtëzimi që ne kemi marrë bazuar në besimin “Unë jam trupi” dhe opinionet që ne mbajmë për veten dhe botën – fillojnë të dekonstruktohen nën fuqinë e vetë-hetimit dhe një pamje më e qartë e jetës përjetohet. Këtu është fillimi i asaj që quhet rruga drejt zgjimit. Ne po dalim nga hudha e gdhëndur nga identiteti personal dhe kushtëzimi që kemi adoptuar për shkak të naivitetit, në atë të një lloj ekzistence spontane.

**-DAMIEN:**

**Pra, ne duhet të vazhdojmë të pyesim veten në mënyrë që të zbulojmë natyrën tonë reale?**

**MOOJI:** Që nga lindja e këtij trupi, diçka në brëndësi ka thënë "Unë" miliona herë. Çfarë është kjo "Unë"? Kjo është një pyetje e vërtetë. Kur shikojmë me ose nga pozicioni i "Unë" personale, ne thjesht ëndërrojmë, por kur kërkojmë burimin e kësaj "Unë", zgjohemi nga gjumi i injorancës në natyrën tonë reale. A mundet kuptimi natyror "unë" ose "unë jam" të jetë thjesht një objekt apo mendim? A është trupi ai që unë në të vërtetë jam? A është ndjenja "unë" një person dhe nëse është, çfarë e percepton atë? Dhe a është edhe kjo një person? Ne duhet ta zbulojmë këtë.

Një që i mediton këto pyetje me sinqeritet dhe seriozitet, zbulon qënien e vet të pandryshueshme dhe të përjetshme. Një i tillë zbulon se "unë" personale në të vërtetë nuk ekziston dhe në thelb bazohet në ide. Duke qënë një konstrukt psikologjik, ai nuk ekziston në realitet dhe për këtë arsye nuk mund të vendosë gjërat. Ajo që në të vërtetë ndodh kur ne flasim për vendime është se një nxitje lind spontanisht nga thellësia e vetëdijes, ajo godet mëndjen e vetëdijshme dhe mëndja e njeh atë dhe thotë: "Unë kam vendosur të bëj këtë apo atë..."

**-DAMIEN:**

**Dhe kjo është e vërtetë edhe nëse egoja duket se përcakton dikë? Edhe një veprim egoik buron nga një vetëdije më e thellë? apo nga ajo që ti e quan Vete?**

**MOOJI:** Po. Për Vetën, egoja është asgjë. Është vetëm për mëndjen psikologjike që vetvetja e imagjinuar besohet se është diçka reale. Ka forca më të mëdha se "personi" në punë, duke luajtur në, si dhe përmes këtij imazhi të botës dhe funksionimit të saj.

Kur zgjohemi nga gjumi i autonomisë egoike, zbulojmë se bota është një lojë hyjnore dhe ne vetce dëshmuesit pa formë të saj. Është realizim sublim – i plotë dhe përmbushës në çdo aspekt. Nëse ne vetëm do të mund të kuptonim se bota nuk është në duart e qënieve njerëzore, të gjithë do të pushonim më shumë, do të kishim besim në fuqinë më të lartë dhe do të shihnim me qartësi, mënçuri dhe gëzim më të madh hyjninë e jetës.

-DAMIEN:

### Por atje ka kaq shumë mosbesim ndaj jetës dhe natyrës në përgjithësi.

**MOOJI:** Qëniet njerëzore kanë zhvilluar një mosbesim themelor ndaj natyrës, por fakti është se nuk është natyra që qëniet njerëzore nuk mund t'i besojnë, por njëri-tjetrit. Qëniet njerëzore nuk mund t'u besojnë qënieve njerëzore. Dhe kjo është kështu sepse vetëpërkufizimi ynë si qenie njerëzore është thjesht një konstrukt artificial – më shumë njerëzor, më pak qenie. Vetëdija krijon një portret të vetvetes si një person i veçantë autonom, që ka nevojë të kujdeset për veten e vet në një mjedis të rrezikshëm dhe të pasigurt të quajtur jetë.

Duke lëvizur brënda kësaj paradigme, ne besojmë se çdo person zotëron një sasi të konsiderueshme, por jo të barabartë, autonomie. Ata që ne i perceptojmë se kanë pozita më të fuqishme në shoqëri sesa tonat, shpesh besohet se përcaktojnë ose ndikojnë në fatin tonë në një farë mënyre. Kjo ngjall një ndjenjë pafuqie dhe frike tek shumë njerëz. Por qëniet njerëzore nuk janë kontrolluesit e vetëdijes, ata vetë janë shprehje të vetëdijes. Vetëdija është më madhështire se njeriu.

Njeriu beson se ai "ka" vetëdije, por e vërteta është se vetëdija "e ka" atë. Ai është thjesht një ide e ngjizur në vetëdije. Përdredhja ose gjëegjëza në dukje është të zbulosh se e kujt është ideja. Pra, nuk ekziston një gjë e tillë që një qenie e vetme njerëzore të ketë fuqi autonome për të bërë si të dojë. Është e gjitha një shfaqje e një të vetme dhe vetëdija është aktori, regjisori, producenti, kritiku, publiku, teatri dhe skena.

Kur ti lexon një libër, çdo personazh në të sillet në një mënyrë të caktuar. Por i gjithë personaliteti i tyre është një krijim i autorit. Nga vijnë këta personazhe? Ata nuk ekzistojnë të pavarur nga autori. Për shëmbull, ty të pëlqen vërtet një personazh në libër dhe ti thua: *"O Zot, më pëlqen shumë zonja Xheni. Ajo është kaq e bukur dhe e mënçur."* Por a e di çfarë? Është autori ai që ty të pëlqen. Historia e një libri dhe personazhet në të janë konceptuar nga autori, ato janë shprehja krijuese e autorit. *"Zoti Xhones, ai dyqanxhiu,"* thua ti, *"Unë e urrej atë njeri, gjithçka që ai mendon për janë paratë dhe makina e tij e vjetër."*

Por kush qëndron në të vërtetë pas personazhit të Z. Xhones? I njëjti autor që shkruan çdo rol. A e sheh?

Dhe pastaj ti vazhdon mendon: *"Oh, po, do të doja që zonja Xheni të binte në dashuri me Xhorxhin. Nëse ajo do të dashurohej me Xhorxhin, do të ishte vërtet fantastike për historinë."* Por kjo është e gjitha bërje e autorit. Atje nuk ka një znj. Xheni që të vendosë për asgjë.

Gjithçka është një krijim i autorit.  
A e kupton?

Zoti është autori pas të gjitha lëvizjeve të shprehjeve të jetës. Kur ti mendon se je një person, atëherë përvoja jote do të jetë sikur ti je duke funksionuar si një qenie autonome faktike. Kur kupton se ti je vet-Vetja, atëherë ti në të vërtetë je një me fuqinë supreme. Janë thjesht shtresa të ndryshme identiteti nëpër të cilat ne funksionojmë përmes dhe si, për një kohë.

Ti nuk je një person, ti je vetëdija. Ajo që ti e identifikon veten si, thjesht varet nga pjekuria e të kuptuarit tënd.

**-DAMIEN:**

**Ne lexuam një herë që ti i the dikujt se nuk ka vullnet të lirë?!**

**MOOJI:** Unë me të vërtetë nuk ia kam paraqitur këtë askujt si një mësim themelor. Unë nuk i predikoj askujt se këtu nuk ka vullnet të lirë. Nuk kam nevojë të them të tilla gjëra. Ajo që duhet të ndaj me ju është shumë më e lartë se kaq. Unë kam thënë se ka vullnet të lirë në dukje, jo vullnet të lirë total. Ekziston një ndjenjë e vullnetit të lirë, sepse vetëdija është e lirë.

Ti ke njëfarë lirie për ta bërë jetën sa më të këndshme që të mundesh, sipas kapacitetit tënd aktual dhe gjithashtu për t'u pjekur më thellë derisa të arrihet një pikë nga ku nuk ka më dëshirë për të kërkuar vullnetin personal. Vetëm kur një identifikohet si person, vullneti i lirë ka aq shumë rëndësi dhe konceptohet në një mënyrë që jeta do të ndihej e padurueshme pa të.

Megjithatë, ky nuk është rasti për një qenie të ndriçuar, sepse pasi qënia është zgjuar në jorealitetin e egos, ajo e gjen natyrën e saj të jetë një me Vetveten kozmike, që është një ekzistencë harmonike. Prandaj asaj nuk i mungon asgjë. Përvojat e tua në jetë ty të tregojnë tashmë se ti nuk je arkitekti i vetëm i ekzistencës tënde. Secili prej nesh ka fuqinë për të ëndërruar, por nuk kemi fuqinë për t'i realizuar ëndrrat tona.

Apo do të thuash se ti je në gjëndje të krijosh pikërisht jetën që ti dëshiron?

Për shëmbull, a ke ti vullnetin e lirë për të takuar dhe martuar personin për të cilën ti vazhdon të fantazosh? Jo.

A ke ti vullnetin e lirë për të shfaqur para si dhe kur të dëshirosh? Jo.

Kështu që të tjera forca po kontribuojnë në jetën që ti e quan tënden. Më duhet të të them këtu se e gjithë kjo është brënda ëndrrës madhështore.

Ne jemi të vetëdijshëm për veten brënda ëndrrës, të cilën ne e besojmë dhe e quajmë realitet. Por për të mënçurit i ashtuquajturit realitet është një ëndërr, të cilën një e observon në brëndësi të qënies së vet. Kjo është pothuajse e pamundur që një qenie e pazgjuar ta kuptojë, sepse një është hipnotizuar aq shumë nga iluzionet sa që e bën atë të besojë se ëndrra dhe identiteti i tij i ëndërruar janë të vërteta. E megjithatë, brënda asaj ëndrre është një çelës dhe një derë që të nxjerr nga ëndrra.

Të mënçurit e njohin rrugën.

Kërko të jesh në shoqërinë e tyre dhe ndiq udhëzimet e tyre.

**-DAMIEN:**

**A thua se ne nuk kemi vullnet të lirë? A nuk mund të ndihet kjo si një koncept mbytës?**

**MOOJI:** Për ata që ndihen të tillë, unë do t'u thoja të ngadalësohen pak dhe të përpiqen që me të vërtetë të ndjekin atë që unë po them këtu. Ndryshe nga sa ti mund të imagjinosh, është nga hiri i jetës, nga hiri i Zotit që ty të lejohet vetëm pak vullnet në mënyrë që ti të mos shkatërrosh ekzistencën tënde. Njerëzit bëjnë gjëra të tmerrshme nga egoizmi, zilia dhe lakmia.

Nëse ti vërtet do të kishe vullnet të lirë, jeta jote do të ishte e tmerrshme. Ti do të zgjidhje vetëm përvoja me shije çokollate që nuk do të sfidonin egon tënde. Por, në esencë, ne nuk rritemi nga brënda me Nutella. Mungesa e vullnetit të plotë të lirë na ndihmon të zhvillojmë shprehjet e bukura të përlësisë, dorëzimit, durimit, dashurisë, mirësisë, pranimit dhe vetëmohimit. Shiko dhe zbulo. Mos u ndje klaustrofobik nga ajo që unë po them. Ka liri të pamasë në të.

Aktualisht, mëndja mendon: "*Nëse unë humbas vullnetin tim të lirë, unë humbas lirinë time*". Ajo nuk e kupton se një që është i lirë nuk ka nevojë për vullnet, sepse një është një me rrjedhën e shpalosur të ekzistencës dhe burimin e saj.



Një nuk ka nevojë të ketë diçka më shumë. Edhe nëse një thotë kështu, është vetëm një mënyrë lozonjare e të thënit.

Nëse një nuk e merr atë diçka, nuk është problem. Ajo që duhet parë është se ne kemi një nocion të ekzagjeruar për vullnetin e lirë. Shpesh kur flasim për vullnetin e lirë, ne nënkuptojmë këtë lloj vullneti egoik, jo vullnetin suprem. Shprehjet e ndryshme të jetës janë tashmë vullneti Suprem. Por a je në gjëndje ta dallosh dhe pranosh këtë? Apo edhe në lutjen tënde, “*U bëftë vullneti yt*”, ti ende po shpreson fshehurazi:

“U bëftë vullneti im”?

**-DAMIEN:**

**Po në lidhje me zgjedhjen; a ka zgjedhje?**

**MOOJI:** Një zgjedhje e mënçur është të ushtrosh vullnetin e dukshëm të lirë për të ndaluar vëmëndjen nga ndjekja e çfarëdo parashikimi apo mendimi që e tërheq atë për të shkuar me identitetin personal, të kaluarën, qëllimin, dëshirën dhe lidhjet, dhe ta kthesh atë çdo herë brënda vetëdijes, qënies, burimit observues.

Vazhdo ta kthesh vëmëndjen në Vete derisa ajo të qëndrojë natyrshëm këtu. Thjesht ji Vetja. Kjo është një shprehje e fuqishme e vullnetit tend të vërtetë, sepse kur e ushtron atë në këtë mënyrë, do të kuptosh se ti je vetëm observues i paanshëm dhe i shkëputur i shfaqjes që kalon përpara teje. Ky kuptim do të përfshijë dhe përshkojë të gjithë përvojën tënde në këtë ekzistencë të kësaj bote.

Jeta ka përsosmërinë, kontrastin, harmoninë dhe bukurinë e saj, por ne të gjithëve na mungon mrekullia e kësaj ekzistence sepse ne duam që ajo të jetë ndryshe nga ajo që ajo është. Dhe jeta nuk është këtu për të përmbushur parashikimet tona. Ajo është ashtu siç ajo është. Kur ti të jesh ashtu siç ti je dhe të kuptosh se ajo është ashtu siç ajo është, do të gesh harmoninë dhe lumturinë e vërtetë të qëndrueshme, sepse tani ti intuitivisht po sheh se je vetë jeta dhe në të njëjtën kohë të ndodh observimi i jetës.

**-DAMIEN:**

**Nëse ne vërtetë jemi shpirt/vetëdije, atëherë pse po e kalojmë këtëpërvojë fizike?**

**MOOJI:** Çfarë nënkupton me përvojë fizike?

Ka një tokë, por ka miliarda botë. Bota që secili prej nesh përjeton është një perspektivë unike psikologjike e jetës, e formësuar nga identiteti, kushtëzimi, edukimi, lidhjet dhe dëshirat tona. Ka kaq shumë faktorë, kryesisht të pagjurmueshëm, që kontribuojnë në mënyrën se si ne perceptojmë dhe nga momenti në moment ky perceptim ndryshon. Kujtesa jep një iluzion se ka një vazhdimësi, por kjo nuk është vazhdimësi e vërtetë. Kujtesa jep iluzionin e stabilitetit, por ai nuk është një stabilitet i vërtetë; është thjesht një foto e ngrirë. Vetëdija në të cilën të tilla imazhe shihen është e vërtetë. Ne jemi kjo vetëdije e pastër dhe gjithmonë e pranishme.

Vetëdija është gjithmonë e përsosur, gjithmonë një. Ajo nuk mund të bëhet e papërsosur apo e ndarë. Është sikur vetëdija dëshiron të shijojë përvojën, por për ta bërë këtë ajo duhet të krijojë ndjenjën e dualitetit. Megjithëse dualiteti është një jorealitet, ajo është një mjet i domosdoshëm për t'u përjetuar dhe për këtë arsye nuk është një gabim. Me ndihmën e dualitetit, vetëdija krijon një ndjenjë të ndarjes dhe përdor lojën e dualitetit për të ribashkuar "pjesët e ndara" në një tërësi që tashmë është dhe që asnjëherë nuk e ka lënë. Ky është paradoksi. Dhe kjo është joga e jetës: e vetmja që shfaqet si shumë. Quhet gjithashtu *leela* ose ndryshe loja e Zotit. Ne jemi të detyruar të zgjohemi nga gjumi i dualitetit në unitetin e ekzistencës. Kjo është loja, mundësia dhe qëllimi i jetës.

Ndërsa jetojmë në vetë-imazhin ose nocionin e të qenit person, duhet të jemi në këtë fushë të kundërtash të ndërlydhura. Ne duhet të kalojmë nëpër të gjitha uljet dhe ngritjet e jetës. Gradualisht, jeta disi bëhet mësuesja jonë. Ne nuk e shohim në mënyrë të dijshme këtë, por vetëdija po piqet përmes të gjitha vështirësive në dukje, duke na sjellë përsëri në një gjëndje zgjimi. Ndërsa ne e kemi këtë trup dhe jemi në gjumë rreth natyrës sonë të vërtetë, ky trup është si pizhamet e qënies. Pra, ti pyet: "*Pse ne, si vetëdije, duhet të kemi një përvojë fizike?*" Mendoj se duhet të ndodhë kështu, sepse pa fiziken, shpirtërorja nuk mund të njihet apo të përjetohej - një tjetër paradoks.

Të gjitha qëniet janë në Satsang. Satsang do të thotë tërheqje drejt së Vërtetës. Të gjitha qëniet tërhiqen nga magneti i Satsangut, por jo domosdoshmërisht

me vetëdije. Fillimisht, kjo tërheqje, ky puls, kjo shtytje, kjo dëshirë imagjinohet të jetë për pasuri, për famë, për para ose për një marrëdhënie. Dhe këto mund të jenë aty, por nuk mund të jenë qëllimi përfundimtar i dikujt, sepse ato janë të gjithë të prishshme, të kufizuara në kohë. Ne mund të shpenzojmë kaq shumë nga ekzistenca jonë duke ndjekur erën, vetëm duke u shqetësuar për manifestimin e shpejtë.

Ajo që nga natyra është e ndryshueshme është edhe hyjnore, është edhe e bukur, por kur përpiqesh të ruash atë që ndryshon, atëherë ti do të vuash. Ne duhet të zbulojmë të pandryshueshmen - realitetin tonë të përjetshëm. Dhe kur kërkimi yt është drejt përfundimit, ti fillon të ndjesh një dashuri të jashtëzakonshme, një qetësi dhe hapësirë të heshtur dhe një ndjenjë të brëndshme të plotësisë dhe kënaqësisë që lulëzon në brëndësinë tënde.

Ti e kupton: *“Eh, gjithmonë kam menduar se isha e ndarë dhe e vecuar—vetëm një pjesë e vogël e një enigme shumë të madhe—por tani shoh se ka një unitet dhe një harmoni brënda zemrës sime.*

*Kur mendoja se isha vetëm trupi, frikësohesha shumë, sepse vëreva që trupi do të zdhukej një ditë dhe e mora atë sikur do të kuptonte se ai do të ishte edhe fundi im; por tani, duke parë nga vëndi i vetëdijes, kuptoj se vetëdija nuk ka lindje, nuk ka vdekje. Natyrshëm e di që jam e përjetshme.”*

Kjo është një ndjenjë krejtësisht e re.

**-DAMIEN:**

**A mendon se kjo përvojë njerëzore mund të na shërbejë disi për të na evoluar, apo është sic ti the - në fund të fundit e njëjta gjë? A nuk ndryshon?**

**MOOJI:** Përsëri, kujtohu se vetëdija, e cila është Vetja jonë e vërtetë, është e përjetshme dhe gjithmonë e përsosur. Kur ajo zgjedh të shprehet si ekzistencë dinamike në formën e një qenieje njerëzore, ajo zbret në sferën e dualitetit duke besuar: *“Unë jam trupi. Kjo jam unë. Unë jam një person i tillë.”*

Duket se nga prindërit tanë e deri te mësuesit tanë dhe bashkëmoshatarët tanë, të gjithë në shoqëri janë në këtë gjëndje mashtruese nga ku ne të gjithë besojmë se jemi individë të veçantë që jetojmë brënda trupave të veçantë dhe se ky është një fakt, një dëshmi e individualitetit dhe autonomisë sonë. Megjithatë, është ende vetëdija që e luan këtë autoportret si një person.

Vetëdija nuk harxhon asnjë shprehje. Ajo duhet të përdorë përvojat që vijnë në jetë, sepse jeta nuk është e ndarë nga lumi madhështor i vetëdijes. Nëpërmjet kësaj loje, vetëdija disi piqet, thellohet dhe evoluon drejt vetënjohjes përfundimtare. Në fushën e dualitetit, ka evolucion, ka ndryshim, ka rritje. Por në fund të fundit, i gjithë ky rafinim po ndodh në sfondin e vetëdijes së pandryshueshme - qënies sonë përfundimtare. Edhe aspirata poashtu edhe vetë kërkimi i së vërtetës është në vetvete fenomenale nga këndvështrimi i vetëdijes supreme. Kur ti shikon nga vetëdija dhe si vetëdije, atëherë kupton se ajo që ti dikur e mendoje veten se ishte, ishte vetëm një rol që luhej nga vetëdija.

Ti vetë ke qënë gjithmonë krejtësisht e paprekur si observues pa formë, pas dhe përtej skenave ndryshuese të lojës së mëndjes. Përsëri, kujtohu, e vërteta përfundimtare është e pandryshueshme. Prandaj, e vetmja mënyrë se si vetëdija e pavdekshme mund ta përjetojë veten si një qenie të vdekshme është përmes mediumit të ëndërrimit. Kjo është arsyeja pse shpesh thuhet se jeta është një ëndërr.

**-DAMIEN:**

**Duket se ka disa njerëz që nuk janë të vetëdijshëm për këtë ëndërr. Disa zgjohen dhe disa jo.**

**MOOJI:** Po, kjo është e vërtetë.

Le të jemi realistë, ne nuk jemi të gjithë në një fazë të barabartë përgjatë rrugës evolucionare drejt zgjimit, e cila është një rrugë që ndodh në lojën e dualitetit. Dallimet do të jenë, natyrisht që po. Fusha e dualitetit në vetvete pa vetëdije për të vërtetën e plotë është një mjedis shumë i paqëndrueshëm, potencialisht duke e kthyer këtë ëndërr jopersonale të quajtur jetë në një makth.

Ata që arrijnë në njohuri më të thella dhe e njohin këtë janë në gjëndje të udhëheqin ata që nuk janë ende aq të vetëdijshëm, por që janë të hapur ndaj mundësisë së zgjimit. Thjesht prania e dikujt që e ka kuptuar të vërtetën përfundimtare nxjerr një lloj ndikimi shpirtëror. Edhe pa qëllim ose përpjekje të vetëdijshme nga ana e tyre, të tjerët ndihmohen sipas aftësisë së tyre për t'u rritur në një njohje më të thellë të natyrës së tyre të vërtetë. Nëse në brëndësinë tënde ekziston aspirata për transformim, kjo aspiratë do të të sjellë ty në shoqërinë e dikujt, prania e të cilit rezonon me ty.

**-DAMIEN:**

**Shumë njerëz flasin rreth të qenit në të tashmen, rreth të jetuarit në Tani, por është e vështirë të shohësh universin, natyrën absolute të gjithçkaje, edhe në momente të thjeshta. Është një gjë shumë e fuqishme që njerëzit të kenë aftësinë për të qenë vazhdimisht të vetëdijshëm.**

**Për shëmbull; nëse unë marr pjesë në një nga Satsanget e tua, ose nëse dëgjoj dikë duke folur, ose dëgjoj një muzikë, ose kur pi një kafe, ose kur eci në rrugë, tërësia është gjithmonë këtu.**

**Si mund të jenë njerëzit të vetëdijshëm përkëtë?**

**MOOJI:** Të mbetesh si vetëdije nuk është aftësi; është qenia e natyrshme dhe gjëndja e pamundimshme e dikujt.

Për sa kohë që ne mbajmë besimin se jemi një person dhe jo prania e paformë, të gjitha përpjekjet tona do të jenë jetëshkurtra. Ndërkohë që kuptimi më i madh të sjell në fushën e zemrës tënde, ajo që ti arrin të zbulosh është se Vetja e vërtetë nuk është diçka që ti bën ose fiton. Vetja e vërtetë nuk është një vepër, por gjëndja jonë natyrale e qënies. Nëse të duhet ta bësh atë, do të ketë raste kur ti nuk je në gjëndje ta bësh atë. Ne qëndrojmë në rrugën tonë sepse ne identifikohemi si një person, gjë që nuk është e qëndrueshme. Personi është gjithmonë i paqëndrueshëm, gjithmonë i luhatshtëm në funksionimin e tij. Por ka një vetëdije më të thellë që vëzhgon këtë luhatje dhe nuk ndikohet prej saj.

Vetja jonë e vërtetë nuk është një fenomen, nuk është një objekt, por subjektivitet i pastër brënda të cilës edhe vetëdija edhe shprehja e saj dinamike perceptohen si lëvizje në vetëdije.

**-DAMIEN:**

**Po, saktësisht. Ne mendojmë se duhet të bëjmë gjëra dhe presim zgjimet e menjëhershme, dritat e mëdha që rrjedhin në fytyrën tonë, dhe unë mendoj se ky është një gabim madhështor sepse është thjesht pritshmëri.**

**MOOJI:** Është sikur nuk mund të arrijmë në pikën e fundit pa shkuar në pikën e mesme. Disi është shumë e rrallë që dikush të zgjojë të vërtetën e plotë menjëherë. Ka diçka për të thënë për kalimin nëpër fabrikën e jetës që prodhon gjithë këtë djersë dhe mund, luftë dhe ëndrra të thyera. Nuk do të thoja se është për asgjë. Është pjesë e pasurisë së përvojës në kërkimin e së vërtetës, sepse nëse e vërteta do të vinte kaq lehtë ajo nuk do të vlerësohej.

E sheh, kjo është arsyeja pse unë them se ne, si vetëdije e kushtëzuar, disi duhet të shtrihemi përtej kapacitetit që ne e imagjinojmë veten se jemi, të sfidojemi derisa të kapërcejmë kufizimet e identitetit të egos dhe të zbulojmë Vetën tonë të përjetshme. Cdokush duhet të fillojë të zbulojë se e vërteta është përtej sferës së dijshe të manifestimeve fizike dhe mendore.

Kur unë them "përtej", nuk po nënkuptoj përtej distancës apo kohës, por përtej hollësisë. Thuhet se nga të gjitha fenomenet, hapësira është më e holla. Pra, ti që je në vetëdijshmëri për hapësirën, duhet të jesh akoma më e hollësishme. E sheh, ndërsa ne po përdorim muskujt tanë mendorë dhe fizikë për të arritur gjëndjen tonë të përjetshme, ne vazhdojmë të humbasim të lehtë dhe të dukshmen.

**-DAMIEN:**

**Po, sepse kur ne jemi të vetëdijshëm për këtë moment dhe kur e lejojmë veten tonë të jetë, ne mund ta ndiejmë këtë paqe, por ajo është shumë jetëshkurtër. Dhe sic edhe ti the, ne atëherë harrojmë dhe bëhemi të zënë në jetë, ose zgjedhim të jemi të zënë dhe shmangim...**

**MOOJI:** Po, sepse ne kemi krijuar një marrëdhënie me identitetin tonë psikologjik në mendjen tonë, dhe kështu ne duam diçka nga bota dhe na duhet mendja për ta arritur atë.

Por kjo është shumë kalimtare, ndaj mos humb kohë në kërkim të asaj që është e përkohshme, sepse një ditë, edhe nëse e merr atë, do ta humbasësh atë përsëri. Pse? Sepse ai që fiton diçka është në vetvete iluzion. Por e e besojmë

këtë dhe besojmë në të. Ka ende dëshira dhe projeksione nga mendja të cilat ne i çmojmë dhe dëshirojmë t'i ndjekim. Megjithatë, për aq kohë sa ne i përmbahemi nocionit të një veteje personale, ne nuk do të jemi në gjëndje të dëgjojmë ndonjë udhëzim që çon në gjëndjen reale. Ne duhet të kapërcejmë vetveten e kufizuar personale duke njohur praninë ose qënien "Unë" dhe së fundmi, absoluten.

**-DAMIEN:**

**Shumë shpesh duket se kjo transendencë është shkaktuar nga dhimbja dhe vuajtja. Për shumë njerëz, marrdhëniet që ata kanë në jetë i sfidojnë ata deri në themel. Duke u thelluar edhe më thellë për të prekur dicka vërtet të vërtetë, është e nevojshme të heqim sa më shumë nga bagazhi ynë psikologjik dhe thjesht të mbajmë gjërat më thelbësore.**

**MOOJI:** Kthehet përsëri në pyetjen tënde të mëparshme se pse ne duhet të kalojmë një përvojë fizike.

**-DAMIEN:**

**Po, po, po.**

**MOOJI:** Në një farë mënyre, pa vuajtje ne nuk shikojmë aq thellë sa duhet.

Ne qëndrojmë në ujërat e cekëta të mendjes dhe personalitetit, të cilat nuk do të të njohin ty me lirinë që ti po kërkon. Dhe më lejo të jem i qartë, liria që unë po theksoj nuk është një liri për egon - për të bërë atë që ti dëshiron - por përkundrazi, liri nga egoja. Dhimbja e vuajtjes është një mjet i fuqishëm për evolucionin e vetëdijes në udhëtimin e saj nga personi në Prani - udhëtimi i vetëzgjimit. Ajo stimulon një synim më të lartë për të vërtetën dhe intensifikon urinë tonë për lirim nga identiteti egoik dhe ndikimi i tij. Ne nuk do të bëhemi të fortë me përvojat e lollypop-it.

Ne duhet të kafshohemi disi, dhe ndonjëherë të përplasemi dhe të ndjejmë dhimbjen e thellë të zhgënjimit, e cila mund të shkaktojë një kërkim më të thellë për Vetën e përsosur. Këto janë gjërat për të cilat rrallëherë ne themi faleminderit, sepse shpeshherë ato mbartin një shije të hidhur.

Por çfarëdo lloj përvojash të dhimbshme që ti duhet të kalosh, këto janë dhuratat e vërteta në jetën tënde, pasi ato në fund të detyrojnë të gjesh atë që në të vërtetë është në krahasim me atë që thjesht duket se është.

**-DAMIEN:**

**Kur ne marrim kohë për të qënë falenderues dhe mirënjohës për këtë moment, kjo vendos gjithcka në një këndvështrim të ri; na ndihmon të rritemi.**

**MOOJI:** Po, dhe ne përjetojmë një ndjenjë shumë më të gjerë dhe më të plotë të qënies. Përpara se zbulojmë të vërtetën, ndonjëherë jemi shumë të ngushtë në këndvështrimin tonë, në mendësinë tonë; ne duam që jeta të jetë e mrekullueshme brenda ngushtësisë sonë.

Por pas disa goditjeve dhe thumbimeve ne jemi të detyruar të maturohemi shpejt. Ne bëhemi më të mprehtë në shikimin tonë dhe zhvillojmë më shumë hapësirë, ndjeshmëri dhe dhëmbshuri ndaj qënieve të tjera. Duke kapërcyer këtë fazë vuajtjeje të trup-mëndjes dhe personalitetit, ne e gjejmë veten më të lumtur, më të mënçur dhe jashtëzakonisht të qetë dhe të kënaqur.

**-DAMIEN:**

**Dhe ne gjithashtu harrojmë më pak... Dua të them se kemi më shumë momente kur kujtojmë se kush jemi në të vërtetë. Kur kemi një pamje/vision më të gjërë, i bëjmë të gjitha këto momente të ndodhin më shpesh në jetën tonë....**

**MOOJI:** Nëse është kështu, atëherë ti ke arritur në një fazë të caktuar nga ku po fillon të shijosh frytet e mrekullueshme të dëshirës tënde të brëndshme. Ndoshta pa vuajtur, pa u kafshuar dhe thumbuar, ne nuk jemi mjaftueshëm mirënjohës apo vlerësues për atë që jeta është. Kështu, ti mund të shikosh prapa dhe të krahasosh se si jeta jote ishte përpara këtij zbulimi dhe se si tani ajo është.

Pra, me këtë ndjen më shumë mirënjohje, dhe hiri mbetet me ty si shoqëruesi yt i vazhdueshëm. Ti humbet pesimizmin tënd dhe bëhesh shumë më paqësor, vetëmohues dhe më pranues të botës si një portret i gjallë i vetëdijes.

Të gjitha këto janë parfumi i lirisë.

Kjo është një shprehje e bukur e vetëdijes në rrugëtimin e saj drejt Vetë-zbulimit. Si një kub akulli në ujë të ngrohtë, atje po ndodh një shkrirje. Akulli është ujë dhe uji është ujë. Ndjenja e personalitetit, megjithëse një gjëndje shumë e kontraktuar e vetëdijes, është gjithashtu vetëdije.



Nëse, me anë të hirit dhe dëshirës sonë për të vërtetën ne udhëhiqemi që ta drejtojmë vëmendjen tonë përbrënda në kërkim të asaj që është reale në veten tonë, ndjenja jonë e personalitetit gradualisht do të shpërndahet në burimin e saj. Nëse nuk do të ishte e tillë, çfarë do ta dëshmonte këtë evolucion të vetëdijes së individualizuar? Dhe për shkak së natyrës gjithmonë të pranishme të Vetes së pastër që jemi, ne nuk kemi nevojë të presim që shkrimja të përfundojë përpara se ky zbulim i burimit tonë të bëhet.

Ky zbulim i së vërtetës është kulmi i të gjitha përpjekjeve njerëzore dhe mund të ndodhë në një çast. Sa lojë e bukur.

**-DAMIEN:**

**Ajo është, po. Faleminderit shumë për kohën tënde, e vlerësoj. Dhe faleminderit që u shprehe kaq qartë...E sjell thjeshtë. Është e bukur.**

**MOOJI:** Ajo duhet të jetë kështu.

Ndonjëherë unë them se e vërteta është e thjeshtë, por kërkuesi i së vërtetës është kompleks. Kjo është për shkak se ne i kemi dhënë shumë vlerë kushtëzimit tonë psikologjik, i cili disi eklipson njohjen tonë intuitive të realitetit tonë të përjetshëm. Satsang e heq këtë vello.

**-DAMIEN:**

**Po.**

**MOOJI:** Dhe shumë njerëz e shohin shumë freskuese të dëgjojnë dhe të përjetojnë të vërtetën që tregohet në një mënyrë të thjeshtë. Ajo i ndihmon ata të njohin atë që është e përsosur e pakohë në brëndësinë e tyre. Prandaj, gëzimi i pamasë çlirohet përmes këtij zgjimi pasi shpirti mund të marrë frymë thellë edhe një herë në dhomën e zbrazët të Absolutit.

**-DAMIEN:**

**Po, vecanërisht në botën perëndimore ku ne mësojmë kaq shumë gjëra. Por pasi ta kesh kuptuar, nuk ke më vërtetë nevojë për të gjitha këto. Është ndryshe...**

**MOOJI:** Ajo është.

tia

# MOOJI

PYETJE DHE  
PERGJIGJE

## TI JE AJO

Cfarë ti je përpara se ti u bëre

Përktheu **Ledion Azemaj**

